



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 88 prot.

Kamëz, më 23.10.2025

V E N D I M
Nr. 74 .Datë 23/10 2025
MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2025”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.10.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.69 Datë 17.10.2025 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji për Kodin Administrativ në Republikën e Shqipërisë, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.88 datë 15.11.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; VKB nr 119 dt.19.12.2024 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2024, 2025, 2026”; Shkresës me nr. Prot. 11049 dt. 27.12.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit të Komisionit të Strehimit me nr. Prot 8967 datë 16.10.2025, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencionin e qirasë për 6 familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi me vlerë **totale mujore 136,000 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) Lekë**.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë dy mujore duke filluar nga data 01.11.2025 deri në datën 31.12.2025,
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 **do të përballohen në raportin 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

